

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM FITUESI PËR DHËNIE ME QIRA

Autoriteti i Dhënies me Qira: Bashkia Vau Dejës njofton se në konkurrimin Publik të zhvilluar me datën 30.12.2025, ora 09:00, publikimi i të cilit është bërë me datën 22.12.2025 në Buletinin e Prokurimeve Publike nr.82, me objekt dhënie me qira:

Fillimi i procedurave për dhënie me qira per 10 (dhjetë) vite, me anë të konkurrit publik për sipërfaqen në total 306.83 ha e ndarë në 5 lote, konkretisht LOTI I me sipërfaqe prej 48.13 ha, ngastra nr.53, fshati Mnele “Per park fotovoltaik (stacionet, objektet perkatese etj)”, sipas Udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”.

Vlera fillestare:

Çmimi dysheme i fillimit të konkurrit është 156.000 (njëqind e pesedhjetë e gjashtë mijë) lekë/ha në vit për sipërfaqe të llojit “Kullote” dhe për 48.13 ha është 7.508.280 (shtate milione e peseqind e tete mije e dyqind e tetedhjetë)lekë në vit për sipërfaqe të llojit “Kullote”, e përlloritur kjo sipas VKM-së nr. 559, datë 29.7.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, i ndryshuar me Vendimin nr. 267, date 27.04.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” dhe sipas Raportit mbi Studimin Tekniko-Ekonomik, përgatitur nga specialistët e fushës.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurën përkatëse të konkurrit publik këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Subjekti “ENERSUN PARK ALBANIA” shpk numri i NIPT-it M58624501C
Oferta e paraqitur për dhënien me qira të sipërfaqes prej 48.13 ha, ngastra nr.53 në fshatin Mnele, LOTI I “Për dhënien në përdorim me afat 10 vjecar të sipërfaqes të llojit “Kullote” prej 306.83 ha (te ndare ne 5 lote) , për ndërtim park fotovoltaik (stacionet, objektet perkatese etj) ne ekonomite pyjore Gjader Mnele.” është prej 7.508.280 (shtate milione e peseqind e tete mije e dyqind e tetedhjetë) lekë në vit pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

S’ka të skualifikuar

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Duke ju referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:Subjektin “ENERSUN PARK ALBANIA” shpk

Adresa: Lezhe, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Pallati “BOGA”, zk 8631, nr pasurie 4/825 +1-8, se oferta e paraqitur, për sipërfaqen prej 48.13 ha, ngastra nr.53 në fshatin Mnele, “për ndërtim park fotovoltaik (stacionet, objektet perkatëse etj)”, me afat përdorimi (qiraje) 10 vite, me oferte prej 7.508.280 (shtate milione e peseqind e tete mije e dyqind e tetedhjetë) lekë në vit pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Bashkisë Vau Dejës, me adresë: Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës dhe referencë kontakti zyrën e sektorit të Prokurimeve Publike, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, sic parashikohet në dokumentat e konkurimit publik, brenda 10(dhjetë) ditëve nga dita e marjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqen nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siigurimi i ofetës suaj, sic parashikohet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.01.2026